



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno / Prodato Received / Delivery	22. 09. 2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Dnteg Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
BRENDSHME	6205/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1143/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1143/2023 të datës 05.09.2023 të ankuesit me adrese banimi:

në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.09.2023, mori këtë.

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me A.nr.1143/2023 të datës 05.09.2023 e parashtruara nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë- Divizionit për Zhvillim të Rekrutimit dhe Inspektimit në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme me Nr.39/2023 i datës 29.08.2023.

A r s y e t i m

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga shkresat e lëndës ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme me datë 11.07.2023 ka shpallur konkursin për emrin e grupit "Specialist të Përgjithshëm të Shëndetësisë / Mjekësisë (RN00012041-Inspektor shëndetësorë, klasa e pozitës profesional 1" në të cilin ka aplikuar edhe ankuesi mirëpo sipas Vendimit me nr.119/2023 të datës 21.08.2023 të Departamentit të Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë-Divizionit për Zhvillim të Rekrutimit dhe Inspektimit në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme i është refuzuar aplikacioni me numër të kodit RAN0016386 i datës 05.08.2022 me arsyetim se nuk i ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas konkursit, ndërsa ndaj këtij vendimi ankuesi kishte paraqitur

ankesë në Departamentin e Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë-Divizionin për Zhvillim të Rekrutimit dhe Inspektimit, më datë 29.08.2023 përmes Vendimit nr.39/2023 i kishte refuzuar ankesën për shkak se i njëjti nuk ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas konkursit, specifikisht nuk ka dorëzuar/bashkangjitur dëshmi, vetë deklaram me shkrim të nënshkruar se nuk ka në fuqi ndonjë masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë.

Ankuesi _____ kundër vendimit me nr.39/2023 të datës 29.08.2023 të Departamentit të Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë-Divizionit për Zhvillim të Rekrutimit dhe Inspektimit në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme me datë 05.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (më tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, e ka proceduar me datë 07.09.2023 kërkesën për përgjigje në ankesë te organi i punësimit. Ndërsa Këshilli me datë 12.09.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 05.09.2023 të parashtruar në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Deklaratë për masë Disiplinore nga ankuesi, Gusht 2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 07.09.2023; Përgjigja në ankesë e datës 12.09.2023; Aplikacioni i ankuesit i datës 05.08.2023; Diplomë e Gjimnazit e ankuesit e datës 18.06.2007; Diplomë e fakultetit e ankuesit e drejtimit Bachelor i shkencave të mjekësisë sanitare; Kopje e vërtetuar nga origjinali nga Noteri e datës 26.06.2019; Certifikatë e ankuesit e datës 03.08.2006; Certifikatë e ankuesit e datës 09.09.2008; Certifikatë e ankuesit e datës 23.10.2008; Licencë e Punës nga OIK e datës 12.03.2019; Letër rekomandimi për ankuesin e datës 26.09.2019; Letër rekomandimi për ankuesin e Korrik 2022; kopja e letërnjoftimit; Pasqyrua e llogaris së Trustit e datës 02.08.2023; Certifikatë e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës mbi dënimet penale për ankuesin me nr.ser. 111F88DFA3ED41C e datës 01.08.2023; Kopja e Patentë Shoferit e ankuesit; Vendimi nga DMZP-MPB e datës 21.08.2023 me nr.119/2023; Ankesa e ankuesit në sistem; Vendimi nga DMZP-MPB e datës 29.08.2023 me nr.39/2023; Lista e Aplikantëve; Njoftimi për listën e ngushtë të kandidatëve; Njoftimi për plotësim ndryshimin e listës së ngushtë; Konkursi me nr.Ref. RN00012041 e datës 11.07.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në lidhje me objektin e kësaj ankese konstaton se në konkursin e shpallur të datës 11.07.2023, për emrin e grupit "*Specialist të Përgjithshëm të Shëndetësisë / Mjekësisë (RN00012041-Inspektor Shëndetësorë, klasa e pozitës profesional 1* ", kërkesat e përgjithshme për pranim kanë qenë :"*Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; të ketë zotësi të plotë për të vepruar; të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji"*, si dhe kërkesat e përgjithshme formale, kanë qenë si në vijim:



- *Arsimimi i kërkuar* :Diplomë e arsimit të lartë në fushat: Mjekësi e Përgjithshme, Mjekësi tjetër dhe Menaxhim Mjekësor.
- *Kualifikime të Posaçme formale*: Licencë për ushtrim të pavarur të veprimtarisë shëndetësore;
- *Përvoja e punës e kërkuar*: Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Ne baze të shkresave të lëndës Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se në konkursin për emrin e grupit "Specialist të Përgjithshëm të Shëndetësisë / Mjekësisë (RN00012041-Inspektor shëndetësorë, klasa e pozitës profesionale 1 " ka aplikuar edhe ankuesi Behar Zeqiri me aplikacionin me numër RAN0016386, ndërsa me datë 21.08.2023 përmes Vendimit me numër 119/2023 të Departamentit të Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë-Divizionit për Zhvillim të Rekrutimit dhe Inspektimit në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ankuesit i është refuzuar aplikacioni për shkak se i njëjti nuk ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas konkursit, specifikisht nuk ka bashkangjitur vet deklarament me shkrim të nënshkruar se nuk ka në fuqi një masë disiplinore të largimit nga një pozitë e zyrtarit publikë të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë, ashtu siç është kërkuar në konkurs përkatësisht në pikën 7 ,ndaj të njëjtit Vendim ankuesi ka parashtruar ankesë përmes portalit elektronik me pretendimin që ti rishqyrtohet edhe njëherë CV ku edhe ka bashkangjitur deklaratën për masë disiplinore. Tutje, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë--Divizioni për Zhvillim të Rekrutimit dhe Inspektimit përmes Vendimit me nr.39/2023 të datës 29.08.2023 ka refuzuar ankesën si të pabazuar me pretendimin se ankuesi nuk ka ofruar dëshminë e kërkuar sipas konkursit me rastin e aplikimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se në konkursin e shpallur të datës 11.07.2023, për emrin e grupit "Specialist të Përgjithshëm të Shëndetësisë / Mjekësisë (RN00012041-Inspektor shëndetësorë, klasa e pozitës profesionale 1 " , dokumentacioni që duhet të paraqitur në rastin e aplikimit, kanë qenë si në pikën shtat (7) të konkursit.

Kolegji i Këshillit, referuar objektit të ankesës lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, me rastin e vendimmarrjes ka marrë për bazë dispozitat Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës nenin 12 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "Aplikacioni përmban këto të dhëna: 1.1. një referencë në shpalljen e konkurrimit; 1.2. të dhënat personale të kandidatit; 1.3. nivelin e arsimit si dhe diplomat e fituara, institucionet arsimore, datat e diplomimit; 1.4. një përshkrim të hollësishëm të përvojës së punës, duke përfshirë: emrin e punëdhënësit, funksionet, titujt, rangjet, kohëzgjatja e punës, një përshkrim i shkurtër i detyrave, numri dhe lloji i personelit nën mbikëqyrje, adresa e punëdhënësit, arsytet për largimin nga vendi i punës; 1.5. njohuritë gjuhësore; 1.6. informata mbi trajnimet e veçanta të kryera, kualifikimet profesionale dhe specializimet, aftësitë e veçanta dhe publikimet; 1.7. njohuritë kompjuterike; 1.8. emri, adresa dhe numri i kontaktit të dy (2) personave referues;" dhe paragrafin 2, ku thuhet "Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurrimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion;" rrjedhimisht ankuesi me rastin e aplikimit nuk ka bashkangjitur të gjitha dokumentet e kërkuara me konkurs, specifikisht ankuesi nuk ka bashkangjitur vet deklarament me shkrim se nuk ka në fuqi ndonjë masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë, rrethanë e konfirmuar edhe nga vetë ankuesi në përmbajtje të ankesës së dorëzuar në këshill.

Kolegji i Këshillit referuar gjithnjë objektit të ankesës dhe me rastin e vendimmarrjes ka marrë për bazë edhe dispozitat nenit 15 paragrafi 5 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku thuhet; “Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve” dhe nenin 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 ku thuhet se: “Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen” dhe si i tillë Vendimi me nr.39/2023 i datës 29.08.2023 i Departamentit të Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë-Divizionit për Zhvillim të Rekrutimit dhe Inspektimit në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi refuzimin e ankesës së ankuesit është i drejtë dhe i ligjshëm.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1143/2023, datë 22/09/2023.

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi,
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/ MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

